

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit Islam Thaçi, me sekretaren juridike Rafete Syla, në lëndën penale kundër të akuzuarit, B. S, për shkak të veprës penale, sulmi nga neni 187 paragrafi 1 i KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II. nr. 63/15, të datës 16.01.2015, të cilën e përfaqësonte Prokurorja e Shtetit Leonora Shemsiu-Kadriu, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më 14.03.2017, shpalli publikisht, ndërsa më 30.03.2017, hartoi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B.S, nga babai A.dhe nëna E, e lindur, H, i lindur më datën ...në Gj, me vendbanim në ...“ ka të kryer shkollën fillore, i punësuar, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. të Kosovës, më parë i pa dënuar si dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale ndaj tij,

ë s h t ë f a j t o r

S e p s e më datën , kohën dhe vendin si në dispozitivin I. të Aktakuzës, i njeiti , për shkak të një mosmarrveshje, e ka sulmuar tani të dëmtuarin Ardonit Sahiti, i cili ishte së bashku me të pandehurin I.Q, në atë mënyrë që e ka goditur më këmbë nëpër pjesë të ndryshme të trupit, duke shtrirë për toke dhe me atë rast derisa kanë ndërhyrë zyrtarët policor dhe e kanë ndarë.

Me çka ka kryer veprën penale sulmi nga neni 187 paragrafi 1 i KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4,41,49,50,51,52,73,74,75 dhe 76, të KPRK-së, e lidhur me nenin 365 të KPPK-së, të akuzuarit , i shqipton,

Dënim me kusht

Ashtu që të akuzuarit, B. S, i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri, brenda periudhës verifikuese prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht ka për t'iu revokuar.

I pandehuri Detyrohet që në emër të paushallit gjyqësor të arkëtojë shumën prej 20€, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnimin e përmbarmit të dhunshëm.

I dëmtuari..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzoet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Temelore në Gjilan, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzë kundër të pandehurit , B. S , për shkak të veprës penale, sulmi nga neni 187 paragrafi 1 i KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën për shqyrtim gjyqësor në të cilën kanë prezentuar Prokurorja e Shtetit Leonora Shemsiu-Kadriu, si dhe i akuzuari....

Pas leximit të aktakuzës i pandehuri ...e ka kuptuar aktin akuzues, përkatësisht veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata e ka njoftuar të pandehurit me të drejtat e tij në kuptim të nenit 323 të KPPK-së, pas këtij njoftimi i akuzuari e ka pranuar fajësinë, për veprën penale, sulmi nga neni 187 paragrafi 1 i KPRK-së, në pajtim me përshkrimin faktik si në dispozitiv **III.** të aktakuzës.

Prokurorja e shtetit në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar : pasi që i pandehuri në këtë fazë të procedurës e ka pranuar fajësinë për veprën penale, sulmi nga neni 187 paragrafi 1 i KPRK-së, po ashtu i njejtë , është njoftuar paraprakisht nga gjyqtari i vetëm gjykues, me pasojat dhe favoret e pranimit të fajësisë, kështu që pas këtij njoftimi i akuzuari vullnetarisht dhe pa presion e shtytje e ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet.

Prandaj i propozoi gjykatës që të akuzuarin t'a shpall fajtorë dhe t'i shqiptoi një sanksion penal meritor, me bindje se dënimi i shqiptuar, do të ndikoj pozitivisht tek i pandehuri.

Në fund kërkoj nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit për të akuzuarin e sipërtheksuar, të ketë parasysh rrethanat lehtësuese edhe ato rënduese. Si rrethana lehtësuese gjykata të merr parasysh, pranimin e fajësisë për veprën e kryer, pendimin për të njejtën, kërkim faljen për të dëmtuarin, si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla, apo të ngjashme penale.

Ndërsa si rrethana rënduese gjykata të ketë shkallën e përgjegjësisë penale si dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuarit.

I akuzuari...., në fjalën e vet përfundimtare, deklaron: e pranojë fajësinëpër veprën penale sipas dispozitivit **III.** të aktakuzës, për të cilën pendohem, i kërkojë falje të dëmtuarit , i premtojë gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tjera penale, e me që jam i papunësuar, kërkojë nga gjykata që brenda mundësive të më shqiptojë një dënim sa më të butë.

Gjyqtari ka vlerësuar se i akuzuari, e ka pranuar fajësinë dhe se pranimi është bërë pasi që i njejtë e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajit nga i akuzuari është bërë vullnetarisht , i mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza si dhe në materialet e prezentuara nga prokurorja e shtetit.

Aktakuza poashtu nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, prandaj në këtë çështje penale gjendja faktike nuk ka qenë kontestuese, andaj gjykata ka gjetur se i pandehuri Bardhyl Sylejmani, në vendin dhe kohën e përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, ka kryer veprën penale, sulmi nga neni 187 paragrafi 1 i KPRK-së.

Andaj të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me kusht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit për të pandehurin , gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikim që dënimi të jetë më i butë apo më i rëndë, ashtu siq e parasheh edhe dispozita e nenit 73 dhe 75 të KPRK-së.

Gjykata në rastin konkret ka gjetur rrethana veçanarisht lehtësuese të cilat mundësojnë shqiptimin e dënimit të kushtëzuar, përmes të cilit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 dhe 50 të KPRK-së. Si rrethanë lehtësuese për të pandehurin, gjykata pati parasysh faktin se i njëjti e ka pranuar fajsinë për veprën penale të kryer, se i pandehuri është i pa punësuar, pa të ardhura materiale, kështu që shqiptimi i dënimit me gjobë ose me burgim do të ndikonte negativisht , gjegjësisht do të përkeqësonte gjendjen ekonomike të tij dhe familjes dhe mbi këtë bazë të pandehurit i shqiptojë dënim të kushtëzuar.

Ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarin, gjykata pati parasysh, shkallën e përgjegjësisë penale si dëmin e shkaktuar të dëmtuarit.

Me dënimin e shqiptuar për të akuzuarin , gjykata vlerëson se do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që të akuzuarin do ta parandalojë që në të ardhmen të mos kryejë vepra tjera penale dhe do të ndikojë edhe tek qytetarët tjerë, që të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 paragraf. 1, e në lidhje me nenin 450 paragraf.1 nën paragraf. 2 .6 të KPRK-së.

I dëmtuari Ardonit Sahiti, konfirmoi nenit 463 të KPRK-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,
Departamenti i përgjithshëm.
P.nr.164/15,më 30.03.2017**

Sekretarja juridike,
Rafete Sylaj,d.v.

Gjyqtari
Islam Thaçi,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.

